

**SAMI MILLOSHI**

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

814-1  
M 76.

# BLEGRIM


*Vjersha*

814-1  
1126

SAMI MILLOSHI

# BLERIM

vjersha



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Tirazhi 2000 kopje      Format 70x100/32      Stash: 2204-72

KOMBINATI POLIGRAFIK — Shtypshkronja e Re  
Tiranë, 1978

## ZEMRA QË NUK HESHT

Nuk e kam thithur tymin e Luftës,  
mishi s'më është përgjakur  
duke ecur këmbëzbathur mbi dëborë  
a duke mbartur mbi shpinë të plagosur.

Nëna që më mëkoi ninulla,  
dhe babai që më mëkoi kujtime,  
e futën kujtimin e martirëve  
të gjallë në zemrën time.

Dhe kur ka ndodhur ndonjëherë  
që zemra të më ketë rrahur më ngadalë,  
koha si gjaku e kuqe  
pak të më rrjedhë në damarë,

ahere zemra e martirëve  
gjak i ka dhënë zemrës sime,  
dhe ajo ka rrahur përsëri  
me ritmin e zemrave të martirëve.

## Q Y T E T A R E

Gjatë gjithë ditës kam dëshirë të punojmë,  
të kuvendojmë për revolucionin, grevat,  
për barrikadat e luftës klasore  
si për jetën tonë, fëmijët e të mbjellat.

Nuk dua të më shkojë kot asnjë sekondë në jetë,  
si ajo pikë e ujit që vadit misrin;  
me shqetësimin për tokën dhe pavarësinë  
gjithë ditën dua ta lëroj shpirtin.

Nuk është e vështirë të meditosh kotësi.  
të merakosesh për rehatinë personale  
dhe luftën për të çarë rrëthimin  
ta barazosh me luftën për një palë sandale.

Nuk është vështirë të përsëritësh të njëjtat fjalë;  
«Ky bulevard është i mrekullueshëm,  
me blinj plot aromë të mirë,  
që na bëjnë më të gëzueshëm.»

O sa i vogël éshtë ky gjëzim  
para gjëzimeve të punës në arë,  
ku djersa jonë tokën vadit  
më mirë se çdo rezervuar.

Ti që në mbrëmje mendohesh  
si përpara tabelës së Mendelejevit,  
mos u kurse të vish nesër në arë  
e të prishësh herët gjumin e mëngjesit.

Ja, tani éshtë mesi i natës  
dhe unë s'e kam fare të vështirë  
që këtë vjershë ta le përgjysmë mbi tryezë  
dhe të shkoj të bëj një gjumë të mirë.

Vërtet askush nuk më sheh  
ç'mund e djersë derdh mbi vargje,  
po kjo nuk do itë thotë se punë e poetit  
nuk njeh disiplinë proletare.

## NË DIMËR

Në dimër s'jam i lodhur  
vetëm me bukën e thekur mbi sobë,  
vetëm me fletoren e poezisë  
dhe me xhupin e ngrohtë.

Në dimër jam i lidhur me grurin  
që fle fushave e kodrave nën borë  
dhe pret drapërinjtë në verë  
siç pret shtëpia dasmorë.

Sikur kokrra e grurit të ngrijë  
edhe kokën mbi dhe mos e nxjerrë,  
me frymë tokën e ngrohim  
dhe farën s'e lemë të mjerë.

Se po të mos mbijë e gjithë fara  
e mos plotësohen bimët për hektar,  
ahere dhe poezia do të mbijë  
rrallë në arën e bardhë.

## S H O K Ë T

I dua shokët e mi,  
më vijnë në kullë ngahera  
dhe odën ma mbushin me kuvend  
për tokën, barutin edhe shqerrat.

Dhe hallet i qajmë së bashku  
që jonxhën mos na e thajë ngrica  
dhe delet në stanet e bjeshkës  
t'i çojmë shëndoshë të gjitha.

Po njëri prej shokëve të mi,  
shastisur prej shkresave të zyrës,  
në kullë ka vite që s'më shkel,  
po më harron tiparet e fytyrës...

Unë shpesh ia kam sharë shastisjen,  
që kurrë të mos ndahet prej nesh,  
dhe hallet t'i qajmë së bashku,  
me ne të gëzojë e të qeshë...

I dua shokët e mi,  
më vijnë në kullë ngahera  
e odën ma mbushin me kuvend  
për tokën, barutin dhe shqerrat.

## POETËT E FUSHËS

Fshatarët hapin kanale të drejta  
dhe tokën drenazhojnë me merak,  
unë i shoh dhe mendoj sa i mirë  
do të ish drenazhimi në art.

Do të rridhnin ujërat e tepërta  
dhe fara e mirë e mendimit  
do të rritej mbi dhe e shëndetshme  
dhe s'do t'i trembej kalbëzimit.

## V J E S H T È

Era fryn dhe bien përdhe  
prej akacies mijëra gjethe,  
Në këto çaste më pushton  
një gëzim i madh në vete.

Toka stoliset në të verdhë,  
ta ndez zemrën gjithë natyra;  
syri s'ngopet duke kqyrur  
mrekullira ngjyra-ngjyra.

Syri s'ngopet duke kqyrur  
misrat dy bojë njeriu.  
Në vetvete s'mund të kyçësh  
një urim që del vetiu.

një urim që del vetiu  
siç del kroi prej burimi,  
për gjithë bujxit tanë të mirë  
në këtë stinë nusërimi.

## HISTORIA E LAGJES ME FËMIJË TOPSHEQERË

### Në dy kapituj

1.

Lagja ime fshatare më thërret ta kujtoj,  
të kujtoj atje ditët që shkova në fëmiri,  
të kujtoj barin e livadheve,  
të kujtoj bashkëfshatarët e mi.

Rruga e lagjes ishte plot me llucë  
ku më mbeteshin opingat në vjeshtë,  
ku më mbetej lopa ime e vetme  
me brinjët që mund t'ia numëroje lehtë.

Lopa ish për mua gjëzimi e hidhërimi  
në fshatin tim malor me kepa shumë,  
ku thembrat më plasariteshin si toka,  
si toka që më linte pa gjumë.

Një livadh sa një tepsi kisha për lopën,  
kufijtë e tij më ngjanin si kufij shteti,  
për ato u shitova në shpatull  
s'di pse ua mbroja dhe centimetrin.

Pastaj erdhën të tjera vite me luftë  
dhe unë mora të tjera plagë,  
kurse e para u mbyll përgjithmonë  
për të mos rrjedhur asnjë pikë gjak.

U mbyll kur tok me gjoksin  
dolëm për lirinë në male,  
dhe pastaj u kthyem të shkulnim  
gardhet e pronës private.

## 2.

I mbaj mend ditët e para të kooperativës  
kur ndokush theri dhentë e preu shumë lisa,  
«Do të vdisni për bukë», kuaknin  
njerëzit amfibë gojëpisa.

Nga njerëzit amfibë në vite të tjerë  
trupi më njozu të tjera plagë,  
që nuk m'i bënte plumbi  
dhe prapë sikur më rridhnin gjak...

Sa shumë gjak që humba  
dhe kurrë nuk u bëra anemik,  
Partia ma injektoi revolucionin  
si gjakun njerëzor në mish.

Dhe kush vdiq për bukën e tregoi historia  
e dyzetkuinalshit për hektarë,  
dhe fëmijët topsheqer si drita  
dhe antena mbi kullën e bardhë.

## DUKE KUJTUAR NJË PLAK TË MIRË

Nuk mund ta harroj atë plak të mirë  
që në vjeshtë na merrte pikat e çatisë  
dhe u bënte nder deleve të mos lageshin,  
të mos lageshim edhe ne njerëzit e shtëpisë.

Ai ka qenë një plak i mirë  
që jetën e ngrysi çati më çati,  
megjithëse në vjeshtë më shumë nga të gjitha  
pikonte nga shirat kasollja e tij.

Ah, plakun e shkrumboi rrufeja  
tek merrte pikat e çatisë,  
dhe ne ëndërronim një dorë  
që të zinte çatinë e Shqipërisë.

Dhe vramë mendjen duke mallkuar rrufenë  
gjersa erdhi një ditë Partia  
dhe na dha armët në duar,  
dhe dorën e mirë ia ndjeu Shqipëria.

Me luftë e kaltëruam qiellin tonë  
dhe ia morëm pikat çatisë,  
jo vetëm çatisë së kasolles sime,  
por në gjithë çatinë e Shqipërisë.

## RECITAL I MALËSORIT

I urdhërohem një grushti dheu,  
një fije bari, një pike uji,  
që ma ndezin gjakun në damarë  
dhe më japin fuqinë e Mujit.

I urdhërohem blegërimës së deleve  
kur i ndjell të gjolla e kripës,  
si ajo nëna kur gjirin e nxjerr  
t'i japë qumësht fëmijës.

Dhe bimëve në arë u urdhërohem  
sí këshillave të urta të nënës, —  
në betejën e bukës do më gjeni  
edhe natën nën dritën e hënës.

Ashtjtë njomë të fidanëve  
të mollëve e të qershisë  
i urdhërohem si buzëve të vajzës  
kur dashuria ëmbël na harlis.

silaj bëroj tuk ngrit  
përmirësim shëngjelën qëndr  
vendosur tuk e gjithë zonë  
fotofoto e përmirësim


## BUKA JONË

Nuk ka qenë më e plotë  
në asnje shekull sofra jonë  
se sa sot që ka në mes  
posi mjalti bukën tonë.

Nëna bukën e pjeston  
me merak për çdo fëmi  
dhe thërrimet ka zakon  
që t'i mbledhë me gishtinj.

Dhe thërrimet tona  
janë më të shëndetshme  
se sa buk' e ardhur  
me vaporë deteve.

Nuk ka qenë më e plotë  
në asnje shekull sofra jonë  
se sa sot që ka në mes  
si baruti bukën tonë.



Si nga një sirenë lufte  
brofim për grurin më këmbë,  
me miellin e tij gatuajmë  
sovranitet e këngë.

## MALLKIM POPULLOR

Një copë bukë e hedhur në rrugë  
përkulet fshatari dhe e merr në dorë,  
Pastaj e ve me respekt mënjanë  
të mos e shkelë ndonjë këmbësor.

Dhe thotë me vete fshatari i mirë:  
— Të vraftë buka, të vraftë buka,  
ty, o njeri, që e hodhe bukën  
dhe e le të mjerë te rruga.

Po buka është bukë e nuk të vret,  
megjithëse është i rëndë si plumbi  
mallkimi popullor ardhur nga shekujt  
kur në magjen e barutit gatuhej dhe brumi.

Një copë bukë të hedhur në rrugë  
përkulet fshatari dhe e merr në dorë,  
pastaj e ve me respekt mënjanë  
dhe thotë me vete mallkimin popullor.

## P O L E M I K È

Unë shpesh të kam dëgjuar kur ke thënë  
se je gjer në palcë fshatar e bir fshatari,  
se di të kositësh e të ngresh mullar  
që të mos kalbet asnjë fije bari.

Unë shpesh të kam dëgjuar kur ke thënë  
se të ka hije shati në dorë,  
se s'ke harruar si mprehet kosa  
megjithëse ke mbaruar goxha shkollë.

Vërtet je gjer në palcë fshatar e bir fshatari  
dhe s'ke harruar të kositësh në lëndinë,  
po vallë vajzën tënde pse s'pranon ta shpriesh,  
të lërë qytetin, të vazhdoj agronominë?!

## BISEDË FAMILJARE

Shkuan shumë vite që kur lamë fshatin  
dhe bëmë shokë dhe miq në qytet,  
të dy e nisëm që nga luga  
kur hymë në apartament.

Tani bijtë na janë rritur  
ata faqen na kanë zbardhur,  
fjalën dysh nuk na e bënë  
as në të ri, as në të plakur.

Dhe s'i mësuam fëmijët tanë  
të rrahin këmbët për akullore,  
për vete mangut ndoshta lamë kostumet  
për ata blemë fletore.

Bijtë tanë s'e harrojnë  
se kemi ardhur me opinga  
në këtë qytet me mollë,  
me bulevardë dhe vitrina.

Prandaj bijtë nuk do t'ngurrojnë  
të kthehen në fshat sërish,  
siç kthehen daillëndyshet  
në çerdhen që kurrë s'u prish.

## MIRË SE TË VISH TE STANI

Kur të përcolla n'universitet  
ti ishe djalë i drojtur,  
po fjalën e thoshe drejt  
dhe punën e bëje shkoqur.

Shkuan vite nga ajo ditë  
ti u bëre me diplomë  
dhe pëlqen të më flasësh  
veç me telefon.

Unë e dua telefonin  
si delen edhe dhinë,  
se me të nga bjeshka  
lajmoj kryesinë.

Lajmoj kryesinë  
për shëndetin e tufës,  
siç lajmon poeti  
visaret e së bukurës.

Unë kam shumë respekt  
për shkencë e kulturë,  
dhe diplomën tënde  
s'e quaj paçavurë.

Po ti eja tek unë  
e më shih te stani  
t'ia themi si atëhere  
këngës që do xhani.

## JETO, BACË, GJER KUR TË DUASH!

Mos vdis, bacë, edhe nesër,  
edhe pasnesër mos vdis!  
Edhe pas një viti mos vdis, bacë,  
edhe pas një shekulli mos vdis!

Jeto, bacë, gjer kur të duash  
veç mos le pa m'i treguar shkëmbinjtë  
ku të kulloj gjaku për lirinë,  
veç mos le pa m'i treguar udhët vajtimtare  
që të përcillnin në kurbet.

Jeto, bacë, gjer kur të duash,  
veç mos më le me merak se nuk m'i the të gjitha:  
çka duhej të më thoshe për të qenë burrë,  
çka duhej të më thoshe  
që si bajraku të mos epem kurrë.

Jeto, bacë! Edhe nesër,  
edhe pasnesër mos vdis,  
edhe pas një viti mos vdis, bacë,  
edhe pas një shekulli mos vdis!

## FYTYRËBUKURI VENDI IM

Dikush pret një çast të vetëm  
vendit tim t'i merren mendtë,  
edhe këmbët ta çojnë në shpellat  
e diplomacisë së fshehtë,

atje ku s'hyn një rreze dielli,  
ku bie erë krematoriumi,  
ku një marrëveshje ta ofrojnë  
si një dozë opumi.

Dhe vallen e superfuqive  
të heqë me pranga në këmbë,  
të flasë me shenja si memeci,  
po metalurgji e këngë.

Po vendi im kurrën e kurrës  
nuk do të bëjë kozmetikë  
para pasqyrave të koniukturave  
siç bëjnë superfuqitë.

Se hijeshon pa pudra  
fytyrëbukuri vendi im,  
tek zë i së vërtetës  
e ka gjithë madhështinë.

## LEGJENDA E BARUTIT

Stërgjyshërit e mi gatuanin barut  
në punishte të thjeshta druri  
që të ngopeshin mirë grykëhollat,  
të vallëvitej i lirë flamuri.

Për barutin ishin meraklinj,  
siç ishin për arat e për dhenë;  
ata donin të ndizej e të shkrepte  
gjëmimtar e zhuritës si rrufetë.

Kushdo që në shekuj ka dashur  
të na lagë barutin e thatë,  
ka parë se shqiptarët e ndezin  
dhe me eshkë e masat...

Që nga punishtet e thjeshta prej druri  
deri te uzinat e sotme moderne,  
gatimi i barutit nga stërgjyshërit  
ka ardhur te ne në formë legjende.

Në shekuj do të shtegtojë legjenda  
t'u tregojë brezave për stërgjyshërit e mi  
dhe brezat do t'i ngopin armët  
që kurrë mos u mungojë baruti i zi...

## R I P È R T È R I T J E

Që nga shpatat e nga hobetë  
gjer në shekullin tonë të atomit,  
gjaku që derdhej e derdhet në luftra  
rri ende pa tharë anembanë globit.

Me traktate çarmatimi  
s'mund ta fshijnë supershtetet,  
se revolta e popujve gatitet,  
shkulmon nga thellësia si detet.

Si Roma në tokën e fqinjët  
kur ngulte thikën majëgjak,  
supershtetet botës i ngulin  
një marrëveshje të fshehtë a traktat.

Po bota me hemoragji  
nuk trembet nga agresioni  
me miliarda qeliza gjaku  
i ripërtërin revolucioni.

## NUSJA E BUKUR ME SHPATË NË DORË

Në odën e pushkës e të sharkisë  
dasmorët kërcenin me ritmin e tupanit  
vallen e rëndë të shpatave  
si të ishin në shesh të mejdavit.

Më i miri valltar kërceu aq fort  
sa për një çast s'i rrahu më zemra  
dhe dasma pa dashur u kthyte në mort,  
të bardhat la nusja dhe veshi të zezat.

Valltarin e mbuluan me flamurin kuq e zi  
se zemra i heshti me shpatë në dorë  
dhe nuk kishte aspak rëndësi  
pse nuk ra në luftë po thjesht si dasmor.

Në odën e pushkëve e të sharkisë  
dasmorët u kujtuan që ishin dasmorë...  
dhe vendin e valltarit e zuri në valle  
nusja e bukur me shpatë në dorë.

## NGRITJA E FLAMURIT NË VLORË

Ja, u ngrit flamuri  
atje në ballkon,  
me zë grykëholle  
burri ligjëron.

Ligjëron vatani  
me të sertin zë,  
s'e duron dushmanin  
të bëjë ligj mbi të.

Të zbetën gjysmëhënë  
s'e duron flamuri,  
qeleshen me çallmën  
nuk e ndërron burri.

Vallet nuk durojnë  
përdredhje haremi,  
nga këto përdredhje  
seç i zë veremi.

S'duron Shqipëria  
që zërin e saj,  
ta shkelin me këmbë  
si ullinjtë për vaj.

## MARTELI I PARË

Kam ecur dikur këmbëzbathur  
mbi dheun tonë flori  
dhe këmbët në tokën e përgjakur  
mirë i mbaj mend dhe tani.

Agai u ndihte fashistëve  
të ngarkonin në mushka ca gurë, —  
edhe kromin tonë e vidhnin,  
i rripnin Atdheut lëkurë.

Unë dola në mal, në çetë,  
fashistëve u ktheva pushkën —  
që të mos na vidhnin lirinë  
u lashë pa ngarkuar mushkën.

Ajo grykë e gjatë pushke  
ish marteli im i parë;  
me të i shporra fashistët,  
me të zbulova thesarë.

## KTHIMET E TURPSHME TË AGRESORËVE

Pasi provuan shpatat dhe topuzët  
dhe dot s'e zhdukën farën shqiptare,  
armiqtë u kthyen të konstruktonin  
armë të tmerrshme, më makabre.

Pastaj ata prapë erdhën  
me helme të zinj e me topa,  
po shqiptarët rilindnin vetveten,  
me gjak rilindnin epoka.

Dhe gratë e mira ëndërronin  
që luftës t'i jepnin binjakë,  
dhe foshnjet i mëkonin me qumështin  
e përzier me barut të thatë.

Pasi përdorën gjithçka:  
topuzë, shkallë, helme e topa,  
armiqtë u kthyen të konstruktonin  
armën që nervat t'i bën të dobta.

Atë armë që e hedhin  
si bombë të përbotshme tymuese,  
që brenda nuk ka tritol  
po reklama e sensacione të bujshme.

Le të konstruktojnë ç'të duan të ligjtë,  
le të bëjnë edhe armë speciale,  
Partia si me qumështin e gjirit  
popullin mëkon me ideale.

Dhe megjithëse kanë kaluar  
e do të kalojnë mijëra vjetë  
popullin tim s'do mund ta shuajnë  
as me ide e as me raketë.

## K A Z M A

Mos i thuaj ti fëmijës  
se po s'mësoi e pret kazma,  
se kazma s'është Ferr i Dantes —  
na ka nderuar e metalta.

Dhe kurrë me të s'kemi të plakur,  
dhe kurrë me të s'kemi të vdekur,  
le të prodhojnë të ligjtë — raketa,  
kem' pushk' e kazëm pér gjak në vetull.

Ndaj do nderuar e metalta,  
me shkollë të madhe e me kulturë,  
njëloj si të ish elektrovinç  
a sikur të ish aparaturë.

## DISA NJERËZ

Kam vënë re se disa njerëz  
ashtu tinëz, me lotari,  
blejnë mobilje dhe kolltuqe  
që t'i kenë deng në shtëpi,

që të habiten mysafirët  
nga atllasi, abazhurët  
dhe nga najloni edhe lulet  
stampuar në të katër muret.

Pa kur i fusin ato kolltuqe  
dhe atë najlon në shtëpi,  
vërejnë se miqtë e mirë  
nuk mahnitën e s'kanë zili.

Vërtet dhe unë kam lënë ca lekë  
atje në arkën e kursimit,  
po mendja kurrë s'më ka shkuar  
t'i ngjajë shtëpia panairit.

\* \* \*

Ne erdhëm drejt njëri-tjetrit  
siç vjen shpërthimi i gjethit dhe aroma e blirit,  
siç vjen urimi «Gëzuar!» në tryezën familjare  
në fillimin e vitit.

Ndaj e quaj të zakonshme  
të të them se të dua,  
kurse ti trembesh sikur  
të shohin që flet me mua.

Në këtë mesditë prilli,  
kur dielli ndrin mbi kokat tonë,  
le t'ia themi njëri-tjetrit  
fjalët e ngrohta.

Të turpëruar janë ata  
që kujtojnë se s'rrotullohet bota,  
kur na vështrojnë vëngër ne  
në çastet e fjalëve të ngrohta.

## DHE ECIM NË UDHËN PLOT DIELL

Qëkur më lindi mua nëna  
eca në udhën plot diell,  
gjithmonë s'harrova sesi  
koha të sit si miell.

Koha të sit si miell,  
koha të nxjerr edhe krunde,  
nga udha plot diell po u ktheve,  
në udhën plot diell po u lëkunde.

Një ditë prej ditësh diellore  
i dhashë fjalën një vajze të bukur:  
«Ty unë të dua sa Deja  
madhështore me borë mbi Macukull».

Por dikush m'i tha vashës se «atje  
jetë moderne s'mund të ketë,  
më sa ka jetë të gjallë  
në Mars e në të tjerë planetë».

Ajo nuk u mërzit aspak  
dhe s'trokiti në asnë zyrë komiteti,  
për një gjysmë kilometër bulevard  
si për një parajsë planeti.

Mrekulli ne rrojmë në Macukull  
dhe ecim në udhën plot diell,  
gjithmonë s'harrojmë sesi  
koha të sit si miell...

## KUR SHKRINË NGRICAT DIMËRORE

Që ti të mos e marrësh veterinerin  
yt atë të kërcënnon çdo natë  
dhe gishtin ta tund para syve,  
të kërkon të mos shkosh në fshat.

Ti ngul këmbë të shkosh atje,  
dashuria pér atë-të përvëlon,  
po ty ndjenjën ta ziejnë  
si gjellën në tenxheren me presion.

Aherë yt atë hakërrohet  
dhe merr në dorë bastunin,  
dhe ta tund para syve  
si Lekë Dukagjini kanunin.

Po ti e di se nuk është babai  
ai që e mban në dorë bastunin,  
se dorën e dhemshur ai e këmbeu  
me dorën e egër të kanunit.

Ah, nuk do të doje kurrë  
pa dasmorë të bëheshe nuse,  
veç dorën babai të mos këmbente  
me dorën e kanunit që të kërruste.

Shkoi vera, vjeshta edhe dimri,  
babai rri ende zemëruar;  
po malli i shpuztë për ty  
shpirtin ia ka përvëluar.

Kur ngricat e tokës dimërore  
nisi të shkrijë pranvera  
me një tufë lulemolle  
shpirtdjegur të trokiti te dera...

## KUR TË RRITESH, O BIRI IM

Gjithë natën të rrimë te koka, o bir,  
ty balli të digjet si furrë;  
mamit tënd i shpëtojnë lotët  
dhe dridhet si shelg në ujë.

Ti as shtatë muaj s'i ke mbushur  
dhe je si një lule prilli,  
nën një diell të ngrohtë me jetë  
i rrëthuar ngado nga gjelbërimi.

Ne rrimë pa gjumë për ty,  
siç ndenjën për ne prindët tanë, —  
zemra kështu u forcoka  
dhe u bëka e paanë.

Ndaj kur tē rritesh, o bir,  
e kur tē kuvendojmë si shokë,  
do tē t'i kujtoj netët e vështira  
që tē ndenjëm me mamin mbi kokë.

## IMAZHI I NËNËS ME VËSHTRIM NGA MALET

Kemi dalë të përcjellim motrën për në shkollë,  
motra do të mësojë për dirigjente,  
krojet ligjerojnë motive të rralla,  
malet na tundin qeleshen.

Nëna hesht me vështrim nga malet  
dhe ndoshta kujton fëmijérinë,  
kur ëndërronte të paktën që bari  
të rritej e të ngopte bagëtinë.

Edhe nëna mund të bëhej dirigjente,  
ajo pati kënduar tok me zogjtë e pyllit  
kur jepte koncertet pranvera  
dhe bariu solist i binte fyellit.

Tani ajo mund ta dinte ç'është simfonia  
dhe ç'do të thotë muzikë e kultivuar,  
po rinia iu tret në mal te bagëtia  
dhe te mulliri ku priste me ditë për të bluar.

Kemi dalë të përcjellim motrën për në shkollë,  
motra do të mësojë për dirigjente.

Imazhi i nënës me vështrim nga malet  
gjithmonë do t'i shfaqet asaj në koncerте.

## KRENARISHT

*Fshatarëve të fshatrave që do të  
përmbyten nga liqeni i Fierzës.*

Do t'i lemë këto troje, këto shtëpi, këto katunde,  
që do të flenë nën liqenin e dritës,  
me mall.

Është malli prej shqiptari,  
dëshirë e shpuztë me vdekë ku kryet na ra së pari.

Do t'i lemë këto troje, këto shtëpi, këto katunde  
me dhembje.

Është dhembje njerëzore  
stolisur me djersën e brezniive  
që çurkoi për plleshmërinë e këtyre trojeve.

Do t'i lemë këto troje, këto shtëpi, këto katunde  
me krenari.

Është krenaria e zemrës sonë bjeshkëtare  
që rreh veç për zemrën e madhe të kombit.

Do t'i lemë këto troje, këto shtëpi, këto katunde  
me gëzim.

Është gëzimi për shtëpitë e reja plot drithë,  
për mijëfishimin e gjallërisë së jetës,  
për horizontet e hapura të së resë,  
për t'paharruarin çast të së nesërmes  
kur do të rivemë në mur pranë pushkës dhe çiftelisë  
portretin e udhëheqësit të Partisë.

## BUJKU I DHEMSHUR

Eshtë sëmurë një ka në arë,  
mbi brazdë atje është shtrirë;  
bujku nxjerr shishen me dhallë  
dhe ia vë në buzë për ta pirë.

Po kau dhallën s'e pi  
dhe nxjerr nga goja shkumë,  
bujku veten shan  
mos e ka lodhur në punë.

Dhe rend bujku i dhëmshur,  
si era, drejt veterinerit  
që kau të ngrihet në këmbë,  
të punojë e të gëzojë si vëllezërit

e të mos rrijë i mërzitur në stallë,  
i sëmurë me ditë e me net  
se toka, si nusja e re,  
farën dhe bujkun'e pret.

## NJË MIJË PLUMBA BALLIT

Selim Pasha në Stamball  
ia lyp Dibrës një mijë cuca,  
për një mijë oficerë  
të jenë belkëputura.

Të një mijë dyfEQET  
si i ngopi mirë,  
krushqit priste Dibra,  
të vinin mysafirë.

Dhe erdhën krushqit  
për një mijë cuca,  
po Dibra u dha  
ballit një mijë plumba.

## TARRACIMI I POEZISË

Kodrat me mollë në tokën dibrane  
i ngajnjë një poeme lirike  
me varg të shtrirë nga fushat  
në kodrat dhe malet epike.

Dhe unë, para kësaj poeme  
kam ulur kokën gjithë nderim  
dhe po punoj si bujk dibran  
ta tarracoj poezinë.

## PASQYRA E LËNDËS

Faqe

Zemra që nuk hesht .....	3
Qytetare .....	4
Në dimër .....	6
Shokët .....	7
Poetët e fushës .....	9
Vjeshtë .....	10
Historia e lagjes me fëmijë topsheqerë .....	11
Duke kujtar një plak të mirë .....	14
Recital i malësorit .....	16
Buka jonë .....	17
Mallkim popullor .....	19
Polemikë .....	20
Bisedë familjare .....	21
Mirë se të vish te stani .....	23
Jeto, bacë, gjer kur të duash! .....	25
Fytyrëbukuri vendi im .....	27
Legjenda e barutit .....	29
Ripërtëritje .....	31
Nusja e bukur me shpatë në dorë .....	32
Ngritja e flamurit në Vlorë .....	33
Marteli i parë .....	35
Kthimet e turpshme të agresorëve .....	37
Kazma .....	39

Disa njerëz .....	40
Ne erdhëm drejt njëri-tjetrit .....	41
Dhe ecim në udhën plot diell .....	42
Kur shkrinë ngricat dimërore .....	44
Kur të rritesh, o biri im .....	46
Imazhi i nënës me vështrim nga malet .....	48
Krenarisht .....	50
Bujku i dhemshur .....	52
Një mijë plumba ballit .....	53
Tarracimi i poezisë .....	54